



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQERIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME
DIBER

DETYRË PROJEKTIMI

OBJEKTI:

“Studim Projektim Ndërtim i rrjetit kryesor furnizimi me ujë i fshatrave të Njësisë Administrative Maqellarë dhe rrjeti shpërndarës fshati Kërcisht i Sipërm”

VEND-NDODHJA: NJA MAQELLARE- BURIMET MBI FSHATRA
POCEST- KATUND I VOGEL

QËLLIMI: SHTIM DHE PËRMIRËSIMI I FURNIZIMIT ME UJË TË
PIJSHËM TE FSHATRAVE TE NJËSISË
ADMINISTRATIVE MAQELLARE.

1.1 TE DHENAT KRYESORE:

Rrethi i Dibres bën pjese ne rajonin verioro-lindor me një relief pergjthesisht malore kodrinor. Pra shtrihet ne veri-lindje te Shqipërise ne dy anet e lugines se drinit te Zi duke u kufizuar ne lindje nga vargmali i Korabit dhe ne perendim nga vargmalet e Lures. Qendra e rrethit eshte qyteti i Peshkopise qe eshte edhe qyteti i 3-te pas atij te Struges dhe Dibres se Madhe ne Republiken e Maqedonise. Qendra e rrethit (Peshkopia) qe shtrihet 178 km nga kryeqyteti dhe 21 km largesi nga pika e doganes se Bllates ne Maqellare. Ky rreth eshte pozicionuar ne keto kordinata gjeografike : **41° 53’ 20”**, dhe **41° 33’ 40”** gjeresi gjeografike veriore dhe **20° 34’ 50”** dhe **20° 07’ 00”** gjatesi gjeografike lindore.

Kufizohet nga kufij konvencionale ne lindje me Republiken e Kosoves dhe te Maqedonise me nje gjatesi kufitare 90 km nga te cilat 19 km jane lumore. Ne veri kufizohet me rrethin e Kukesit me 75 km vije kufitare. Ne perendim me Mirditen 13 km vije kufitare dhe me rrethin e Matit me 60 km vije kufitare. Ne jug me Bulqizen 27,8 km vije kufitare.

Ky rreth ka nje ndertim te komplikuar gjeologjik qe eshte kapur here pas here nga levizjet neotektonike ngritese qe ka luajtur nje rol te rendesishem ne formimin e

rrelievit. Rethi i Dibrës ka nje relief kodrinor-malor qe varion nga 350 m (lugina e drinit te zi) deri ne 2751 ne majen e Korabit.

Ben pjese ne zonen klimatike mesdhetare malore dhe mesdhetare para malore meqenese eshte pjese perberese e pellgut te Drinit te Zi.

Ka nje hidrografi te pasur me burime mbi tokësore dhe nen tokësore ku dega kryesore është Drini i Zi.

Dibra dallohet per shumellojshmerine e tokave te cilat per shkak te relievit malor shprehen qarte. Gjejmë brezin e tokave aluvionale rreth lumit te Drinit te Zi, te kafejta, te murrme pyjore dhe ate livadhore malore. Ne këtu takojmë breza bimore si : brezi i dushqeve, ahishteve dhe kullotave alpine. Ky rreth ka një popullsi prej 75,000 banoresh te vendosur ne 1088 km² kryesisht ne vendbanime te rralla e rurale.

II. GJENDJA E FURNIZIMIT ME UJE TE FSHATRAVE TE NJËSISË ADMINISTRATIVE MAQELLARE

Fshatrat e Njesise Administrative Maqellare (kjo njesi administrative perfshin ne total 22 fshatra), kane probleme te theksuar ne furnizimin me uje te pijshem.

Ujesjellesi i Maqellarës i ndertuar ne vitin 2005 perfshin depo akumuluese $V=1000m^3$ vendosur ne kuote solete +685.44

Rrjet shperndares si dhe ujematesa ne abonente. Furnizimi me uje realizohet sot me ngritje mekanike permes dy stacioneve te pompimit ne kuote +550. Shfrytezimi i ketyre burimeve pervec kosos per pagesen e furnizimit me energji elektrike, shfaqin parametra fiziko-kimike, sic eshte fortesia minerale jashte parametrave optimale per nevoja ekonomike-pirje te ujit. Per kete arsye uji nga ky burim nuk perdoret nga banoret.

Furnizimi me uje realizohet ne menyre individuale nga banoret e zones.

III. DETYRA E PROJEKTIMIT

Te dhenat dhe kerkesat e Detyres se projektimit:

- Popullsia sot ne 10 fshatrat qe do te furnizohen me uje 6.848 banore
- Numri i familjeve 2239
- Perspektiva llogaritese 25 vjet
- Rritja e popullsisë ne vite do te merret sipas të dhënave të fundit të INSTAT.
- Norma e konsumit per fryme 100 litra/dite per fryme, 75 litra/dite per nxenes, 40 litra/dite per klient per biznese dhe per bageti nje shtese sipas normave.
- Per konsumatore te tjere nevojat per uje te pijshem te llogarriten 15% e nevojave te popullsisë.
- Humbjet per rrjetin kryesor nga vepra e marrjes deri ne depo te llogarriten 3-5%, per rrjetin shperndares 15-17%.
- Projekti dhe preventivi i punimeve te zbatimit, ne kete faze studimi te behet per “Ndërtim i rrjetit kryesor furnizimi me ujë i fshatrave të Njesisë Administrative Maqellarë dhe rrjeti shpërndarës fshati Kërcisht i Sipërm”.

- Materiali i tubacionit të jetë : Prej Çeliku dhe HDPE i çertifikuar (PE / RC).

OBJEKTIVI:

Objekti i detyrës së projektimit është hartimi i projektit të *“Studim Projektim Ndërtim i rrjetit kryesor furnizimi me ujë i fshatrave të Njësisë Administrative Maqellarë dhe rrjeti shpërndarës fshati Kërcisht i Sipërm”*

1. Studimi dhe gjetja e burimeve
2. Ndertimi i kaptazheve (Vepra e marrjes).
3. Rrjeti Kryesor nga vepra e marrjes deri ne Depo egzistuese Maqellare.

QËLLIMI I PUNËS:

Për realizimin e projektit, projektuesi duhet të rishikojë të gjithë informacionin egzistues lidhur me projektin që duhet të hartojë sipas detyrës së projektimit dhe të konsultohet me njësinë e qeverisjes vendore te NJA Maqellare, Bashkia Diber dhe Drejtues te Shoqerise Rajonale te Ujesjelles Kanalizime Diber.

Cilësia e studim projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet standarti i kërkuar dhe të plotësojë kushtet e projektimit.

Kërkesat që duhet të zgjidhë Projekti:

Projekti i hartuar duhet të përmbajë :

1. Koorografinë në shkallë 1:25000
2. Planimetrinë e rrjetit ne shkallë 1:1000; 1:5000.
3. Profilin gjatësor në shkallë H 1:1000; V 1:500.
4. Profila tërthorë në shkallë 1:20.
5. Detaje të ndryshme në shkallë 1:50.
6. Planimetri, prerje, detaje te ndertimit te depove.
7. Relacioni teknik për zgjidhjen e dhënë sipas detyrës së projektimit.
8. Llogaritjet hidraulike .
9. Llogaritjet konstruktive .
10. Preventivi i kryerjes së punimeve, duke u mbështetur në çmimet e Manualit te Çmimeve qe jane ne fuqi ose të shoqëruara me analizat përkatëse.
11. Specifikimet teknike të zbatimit të projektit .
12. Projekt preventivi të paraqitet në tre kopje dhe në formë dixhitale.
13. Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.
14. Raporti topografik.
15. Raporti hidrogeologjik i burimeve.

REKOMANDIME PËR PROJEKTUESIN

- ✓ Projektuesi duhet të përdorë dhe rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me realizimin sa më të plotë të këtij projekti.
- ✓ Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje dhe atyre gjatë zbatimit.
- ✓ Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standarteve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.
- ✓ Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar.

ORGANIZIMI, PLANI PUNËS

- ✓ Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me stafin e inxhinierëve në Shoqërinë Rajonale Ujesjelles Kanalizime Dibër Sh.a.
- ✓ Vizatimet do të paraqiten në shkallën e përshtatshme dhe të lexueshme e caktuar kjo nga projektuesi.